

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA E GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
Data:		23.12.2019	
Nr. Org.	Numër	Statjua	Vlera
01-	060-	70445	

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

Komuna / Opština: <u>Drenas</u> Data / Datum: <u>18.12.2019</u>
Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 7
Takim i rregullt / Redovni sastanak <input checked="" type="checkbox"/> Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak <input type="checkbox"/>
Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>15</u>
A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?
Po / Da <input type="checkbox"/> Jo / Ne <input type="checkbox"/> Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice <input checked="" type="checkbox"/>
A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?
Po / Da <input checked="" type="checkbox"/> <i>Burim Jonuzi zyrtar i Komisionit Komunal për Zgjedhje (KKZ), përfaqësues të KFOR-it dhe OSBE.</i> Jo / Ne <input type="checkbox"/> <i>Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju</i>
A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo Nënkyetari? Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?
Po / Da <input checked="" type="checkbox"/> Nënkyetari Jo / Ne <input type="checkbox"/>
Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:
<i>Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:</i>
<ol style="list-style-type: none"> 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur më 24.10.2019; 2. Diskutim lidhur me ecurinë e zgjedhjeve të fundit; 3. Diskutim lidhur me çështje të ndryshme si rezultat i strehimit të personave të prekur nga tërmeti në Shqipëri;
<i>Propozim nga KLSP Komoran</i>

4. Diskutim lidhur me shqetësimet e qytetarëve në lidhje me qentë endacak;
5. Diskutim lidhur me orarin e mësimit në shkolla;
6. Të ndryshme.

Konkluzionet / Zaključit:

Mbledhjen e gjashtë të rregullt për këtë vit të cilën e kryesoi nënkryetari i Komunës së Drenasit, Nazmi Hasi.

Të pranishëm ishin shumica e anëtarëve e KKS-së, përfaqësuesi i KKZ-së për komunën e Drenasit, dhe monitorues nga OSBE-ja dhe përfaqësues nga KFOR-LMT9.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKS-së të mbajtur më 24.10.2019 u miratua unanimisht pa vërejtje.
2. Sa i përket pikës së dytë, diskutim lidhur me ecurinë e zgjedhjeve të fundit, i pranishëm ishte Burim Jonuzi nga KKZ Drenas, i cili i njoftoi të pranishmit për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe se gjatë procesit nuk ka pasur probleme dhe falënderoi Komunën për ofrimin e objektit për trajnimin e stafit.
3. Për pikën e tretë u tha se edhe në Komunën tonë pati të strehuara disa familje, detajet e të cilave u paraqitën në një raport të veçantë dhe se Komuna jonë ka marrë të gjitha masat e nevojshme sa i përket shkollimit të fëmijëve të atyre familjeve. U rekomandua që për raste të ngjashme të ekzistojë një koordinim më i mirë e po ashtu të thirret edhe mbledhja e KKS-së.
4. Për pikën e katërt u raportua se kanë qenë dy raste të raportuara të sulmeve nga qentë endacakë. U tha se ky është një problem kronik dhe çdo zgjidhje e pjesërisht nuk ndikon në zgjidhjen e këtij problemi. Trajtimi i qenve endacakë është centralizuar dhe tani pas zhvillimit të proceduarve do të bëhet publik numri i operatorit ekonomik i cili do të merret me trajtimin e tyre dhe që qytetarët do të kenë mundësinë që ta thërrasin atë. U rekomandua që zyrtarët komunalë dhe policia ta ngritin këtë çështje në nivele me të larta në mënyrë që qendra ta ketë të qartë seriozitetin e problemit.
5. Për pikën e pestë, nënkryetari i komunës së Drenasit, Nazmi Hasi i njoftoi të pranishmit se vendimi për kohëzgjatjen e orës mësimore është përcaktuar nga MASHT-i, por që megjithatë drejtorët e shkollave e kanë mundësinë që të marrin vendime në përputhje me rrethanat e sigurisë së nxënësve. U rekomandua që aty ku ka mundësi mësimi të zhvillohet brenda një ndërrimi.
6. Për të ndryshme, si temë u paraqitën raportet e fundit për cilësinë e ajrit në Komunën e Drenasit. U vlerësuan hapat e marrë nga Komuna për ndalimin e përdorimit të fishekzjarrëve dhe Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit dhe u rekomandua që të krijohet një grup i cili do të monitoronte zbatimin e planit të përmendur.

Procesverbali aprovet nga Kryetari:

Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Udrovci


nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobranja: 23.12.2019

Rekomandimet:

- *Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;*
- *Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSb-së në Komunën përkatëse;*
- *Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net*
- *Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net*
- *Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSb-së.*